


Siguri

Ekskluzive | Të shtëna në një aheng në Gllamnik të Podujevës – dy familjarë dorëzojnë armët para Policisë



Sinjali.com

03 Gusht 2026 10:49



Dy persona janë proceduar penalisht pasi në një aheng familjar në fshatin Gllamnik të Podujevës dyshohet se është përdorur armë zjarri, ndërsa në vendin e ngjarjes Policia ka sekuestruar armë dhe municion.

Sinjali mëson se të dyshuarit janë Elhami Abdullahu rreth 42 vjeçar dhe Ismet Abdullahu rreth 51 vjeçar

Sipas burimeve, më 2 gusht, rreth orës 23:00, Policia ka pranuar informacione operative për të shtëna me armë zjarri gjatë një ahengu familjar në fshatin Gllamnik.

Pas mbërritjes së njësive policore në vendin e ngjarjes, Ismet Abdullahu ka pranuar se kishte shtënë tri herë me një pistoletë me gaz, të cilën më pas e ka dorëzuar vullnetarisht. Në vendngjarje janë gjetur edhe tri gëzhoja, që dyshohet se i përkasin armës së përdorur.

Ndërkohë, Elhami Abdullahu ka deklaruar se posedonte një armë zjarri me pesë fishekë, të cilën gjithashtu e ka dorëzuar vullnetarisht. Ai ka pohuar para hetuesve se nuk kishte shtënë me atë armë.

Të dy të dyshuarit janë shoqëruar në Stacionin Policor në Podujevë, ku janë intervistuar në prani të avokatëve mbrojtës.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, rasti është iniciuar për veprat penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Pas përfundimit të procedurave, të dy të dyshuarit janë liruar në procedurë të rregullt, ndërsa arma, municioni dhe provat e tjera materiale janë sekuestruar. Hetimet për rastin vazhdojnë.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/


Aheng

arme

gllamnik

shtena

Të tjera:



E rëndë në Podujevë: Vajza e mitur denoncon babain e saj, thotë se e rrahu dhe e ngacmoi...

Siguri



Gjendja në Gllamnik të Podujevës pas reshjeve të shiut (FOTO)

Sociale



Dy të lënduar në një aksident trafiku në Gllamnik

Siguri



Policia/ Goditi çiklistin, shoferi i veturës ikën nga vendi i ngjarjes

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera